



Nisma për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse

Anketa mbi Impaktin e EITI ne Komunitet

Pergatitur nga:

Sekretariati Nisma per Transparence ne Industrine Nxjerrrese

Tetor, 2014

Nisma EITI në Shqipëri – Analiza dhe interpretimi i të dhënave të anketimit

Në periudhën 23 shtator - 13 tetor 2014, Sekretariati Shqiptar EITI zhvilloi një ankete mbi impaktin EITI në komunitet, konkretisht se sa njohuri kanë qytetarët rreth industrisë nxjerrëse në përgjithësi dhe rreth Sekretariatit EITI Shqiptar. Anketimi u zhvillua në komunitetet ku kryesisht operon industria nxjerrëse si: Tiranë, Kukës, Bulqizë, Patos, Librazhd dhe Perrenjas.

Perzgjedhja e këtyre zonave u bë në bazë të veprimtarisë nxjerrëse:

Tiranë – Te gjitha institucionet, shoqëritë civile, kompanitë e industrisë nxjerrëse kanë zyrat e tyre të përfaqësimit në kryeqytet;

Kukës – Në këtë zonë operojnë kryesisht kompanitë të nxjerrjes së bakrit;

Bulqizë – Është zona ku operojnë shumica e kompanive minerare të kromit;

Patos – Është zona ku operojnë disa prej kompanive të naftës;

Librazhd dhe Perrenjas – Është zona ku operojnë disa prej kompanive të hekur-nikelit.

Në secilën prej zonave të sipërpermendura janë anketuar 100 qytetarë duke përfshirë specialiste të Administratës Shtetërore, specialiste të Bashkive dhe Komunave, nxënës të shkollave të mesme, studentë, minatorë, naftetarë, policë, organizata të Shoqërisë Civile, gazetarë, qytetarë, pra në një total prej 500 të anketuar.

Pyetësi i konsistoi në 18 pyetje, ku shumica prej tyre ishin pyetje të mbyllura “Closed –Ended Questions”. Të gjitha pyetjet janë analizuar duke përdorur programin statistikor SPSS. Gjithashtu secila pyetje është analizuar si një variabël më vete për të marrë një shifër sa më të saktë statistikore. Duhet theksuar që disa pyetje janë lënë pa përgjigje nga ana e të anketuarve dhe në tabelat përkatëse rezultojnë si përgjigje të munguara (missing). Më poshtë do shihni secilën pyetje të analizuar më vete dhe me tabelat përkatëse të marra nga programi SPSS. Në fund të këtij raporti analize dhe interpretimi i të dhënave të marra nga anketat do gjeni të gjitha tabelat me të dhënat grafike.

Numri i personave te anketuar eshte 500 (Tabela1)

City of responder		
	Frequency	Percent
Valid	Tirana	100 20.0
	Patos, Selenice	100 20.0
	Bulqize	100 20.0
	Kukes	100 20.0
	Perrenjas, Librazhd	100 20.0
	Total	500 100.0

Tabela 1

Nga ky kerkim rezulton se 52 % e te anketuarve jane meshkuj dhe 48 % e te anketuarve jane te moshes 18-35 vjec (Tabelat 2 dhe 3)

Gender		
	Frequency	Percent
Valid	Male	260 52.0
	Female	240 48.0
	Total	500 100.0

Tabela 2

Age of responder		
	Frequency	Percent
Valid	18-35	240 48.0
	35-40	83 16.6
	40-45	62 12.4
	45-50	44 8.8
	mbi 50	71 14.2
	Total	500 100.0

Tabela 3

Pyetja e parë: Jeni në dijeni të ndonjë aktiviteti të industrisë nxjerrëse në komunitetin /qytetin tuaj?

Nga interpretimi i të dhënave rezultoi që 300 persona, 60 % e të anketuarve janë në dijeni të një aktiviteti nxjerrës në zonën e tyre.

Are you aware of any extractive activity in your community/city?

	Frequency	Percent
Valid Yes	300	60.0
Valid No	191	38.2
Total	491	98.2
Missing 9.00	9	1.8
Total	500	100.0

Tabela 4

Nga verifikimi i pyetësorëve vihet re që në qytetin e Tiranës shumica të anketuarve nuk kanë informacion rreth industrisë nxjerrëse. Në zonat e Patosit, Bulqizës, Kukësit, Librazhit e Perrenjasit, pjesa me madhe e të anketuarve kanë informacion rreth industrisë nxjerrëse madje duke u shprehur për llojin e aktivitetit që ushtrohet në zonat respektivisht naftë, krom apo hekur-nikel.

Pyetja e dytë: A e dini emrin e kompanisë/institucionit që po ushtron veprimtarinë në këtë zonë?

Rezultoni se 39.2 % (196 persona) zoterojnë informacion për të paktën një kompani që operon në industrinë nxjerrëse. Duke marrë në konsideratë që 45.8% (227 persona) e të anketuarve i janë përgjigjur negativisht dhe 15% (75 persona) e kanë lënë pa plotësuar këtë pyetje, mund të themi që infomacioni rreth emrit e të paktën një kompanie që ushtron veprimtari në këto zona është i paktë. (shih tabelën 5) Kjo na çon të kuptojmë se sa larg kontributit social janë kompanitë që operojnë në zonat nxjerrëse.

Do you know the name of the company/institution that is operating in this area?

		Frequency	Percent
Valid	Yes	196	39.2
	No	229	45.8
	Total	425	85.0
Missing	9.00	75	15.0
Total		500	100.0

Tabela 5

Pyetja e tretë: A jeni në dijeni të ndonjë pagese të kryer nga kjo/këto kompani?

Shumica e të anketuarve, 55 % (275 persona), janë përgjigjur që nuk kanë informacion, nëse kompanite nxjerrëse që operojnë në qytetin e tyre kryejnë pagesa ndaj institucioneve.

Are you aware of any payments made by this/these company (ies)?

		Frequency	Percent
Valid	Yes	131	26.2
	No	275	55.0
	Total	406	81.2
Missing	9.00	94	18.8
Total		500	100.0

Tabela 6

Pyetja e katert: A e dini kush është përfituesi i pagesave?

Shumica e qytetarëve, mendojnë se përfituesi i këtyre pagesave është kryesisht qeveria qendrore 35.6% e të anketuarve, e ndjekur nga komuniteti 24.8%, bashkia 22.8%, personale 17.6 % dhe alternative e fundit ajo e deputetit 4%. (Tabelat 7-11)

Government

		Frequency	Percent
	No	143	28.6
Valid	Yes	178	35.6
	Total	321	64.2
Missing	9.00	179	35.8
Total		500	100.0

Tabela 7

Community

		Frequency	Percent
	No	197	39.4
Valid	Yes	124	24.8
	Total	321	64.2
Missing	9.00	179	35.8
Total		500	100.0

Tabela 8

Municipality

		Frequency	Percent
	No	207	41.4
Valid	Yes	114	22.8
	Total	321	64.2
Missing	9.00	179	35.8
Total		500	100.0

Tabela 9

Personal

		Frequency	Percent
	No	233	46.6
Valid	Yes	88	17.6
	Total	321	64.2
Missing	9.00	179	35.8
Total		500	100.0

Tabela 10

Parliamentarian

	Frequency	Percent
No	301	60.2
Valid Yes	20	4.0
Total	321	64.2
Missing 9.00	179	35.8
Total	500	100.0

Tabela 11

Pyetja e pestë: A e dini se për çfarë përdoren këto pagesa?

Kesaj pyetjeje 55% e te anketuarve nuk i jane pergjigjur. 45% e te anketuarve jane pergjigjur qe keto pagesa perdoren kryesisht per infrastrukturen publike dhe per buxhetin e shtetit.

Pyetja e gjashtë: Keni dëgjuar për Nismën për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse (EITI)?

Kjo pyetje përbën objektivin kryesor të këtij pyetësori. Rezultoi që shumica, prej 363 persona, 72% e te anketuarve, nuk kanë informacion rreth Sekretariatit EITI Shqiptar. Ne kete kuader eshte e nevojshme nisma e nje fushate publicitare, për të përhapur informacionin rreth iniciatives EITI per publikun e gjerë.

Megjithese ne perpilimin e raporteve EITI, administratorët e kompanive nxjerrëse dergojne informacion per veprimtarine e kompanive te tyre, dhe kane dijeni per veprimtarine EITI, shumica e punonjesve qe punojne ne keto kompani nuk kane dijeni te iniciatives EITI.

Gjithashtu ne te gjitha seminarete qe jane organizuar nga sekretariati EITI ne keto zona kane qene te pranishem perfaqesues te administrates lokale, perfaqesues te shoqerise civile, perfaqesues te kompanive, megjithate perhapja e informacionit ne komunitet eshte e ulet.

26.2% e te anketuarve që janë përgjigjur pozitivisht kësaj pyetje kanë marrë informacion rreth EITI kryesisht nëpërmjet TV, 14.8% e te anketuarve. (shih tabelen 12 dhe 13)

Have you heard about the EITI?

	Frequency	Percent
Valid Yes	131	26.2
Valid No	363	72.6
Total	494	98.8
Missing 9.00	6	1.2
Total	500	100.0

Tabela 12

If Yes, How?

	Frequency	Percent
Valid Radio	1	0.2
Valid TV	74	14.8
Valid Newspaper	11	2.2
Valid Sensitization seminar	12	2.4
Valid Internet	33	6.6
Total	131	26.2
Missing 9.00	369	73.8
Total	369	73.8
Total	500	100.0

Tabela 13

Pyetja e shtatë: Nga të kuptuarit tuaj për çfarë shërben EITI?

Përgjigjet e kesaj pyetje janë pesë alternativa si: Transparenca, Pagesa dhe të ardhura, Besueshmëria, Korrupsioni, Mjedisi. Ne total kesaj pyetje i jane përgjigjur 452 persona prej te anketuarve. Prej tyre, 348 persona (69.6%) i janë përgjigjur alternativës së parë, asaj të Transparencës, vijuar me 132 persona (26.4%) Besueshmeri, 93 persona (18.6%) Mjedisi, 75

persona (15%) Pagesa dhe te Ardhura dhe alternativa që ka marrë më pak përgjigje është alternativa e Korrupsionit me 50 përgjigje (10 %). (shih tabelat 14 - 18)

Transparency

		Frequency	Percent
	No	104	20.8
Valid	Yes	348	69.6
	Total	452	90.4
Missing	9.00	48	9.6
Total		500	100.0

Tabela 14

Payments and Revenue

		Frequency	Percent
	No	377	75.4
Valid	Yes	75	15.0
	Total	452	90.4
Missing	9.00	48	9.6
Total		500	100.0

Tabela 15

Accountability

		Frequency	Percent
	No	320	64.0
Valid	Yes	132	26.4
	Total	452	90.4
Missing	9.00	48	9.6
Total		500	100.0

Tabela 16

Corruption

	Frequency	Percent
No	402	80.4
Valid Yes	50	10.0
Total	452	90.4
Missing 9.00	48	9.6
Total	500	100.0

Tabela 17

Environment

	Frequency	Percent
No	359	71.8
Valid Yes	93	18.6
Total	452	90.4
Missing 9.00	48	9.6
Total	500	100.0

Tabela 18

Pyetja e tetë: Çfarë mendoni për implementimin EITI në Shqipëri?

Pyetja e nente: A mendoni se Shqipëria duhet të jetë pjesë e procesit të implementimit EITI?

Pyetja e tete është një pyetje e hapur (open-ended question), qëllimi i se ciles është për ti lënë të anketuarit të shprehin se çfarë ata mendojnë për nismën EITI dhe për të parë nëse kjo nisëm perceptohet pozitivisht. Duke qene kesaj pyetje shumica e te anketuarve nuk i jane pergjigjur por i jane pergjigjur pozitivisht pyetjes se nente “A duhet te jete Shqipëria pjese e procesit te implementimit EITP”, arrijme ne konkluzionin se nisma perceptohet pozitivisht. Konkretisht 440 persona (88%) e te anketuarve jane pergjigjur Po, Shqipëria duhet te jete pjese e implementimit EITI. (Tabela 19)

Do you think Albania should be part of the EITI Implementation Process?

	Frequency	Percent
Valid Yes	440	88.0
Valid No	25	5.0
Total	465	93.0
Missing 9.00	35	7.0
Total	500	100.0

Tabela 19

Pyetja e dhjetë: A jeni në dijeni të përfitimeve për Shqipërinë nga implementimi i EITI?

Vihet re se 399 persona (79.8%) e të anketuarve nuk kanë dijeni se cilat janë përfitimet e Shqipërisë nga Nisma EITI. (Tabela 20)

Are you aware of the benefits of the EITI Implementation Process in Albania?

	Frequency	Percent
Valid Yes	72	14.4
Valid No	399	79.8
Total	471	94.2
Missing 9.0	29	5.8
Total	500	100.0

Tabela 20

Pyetja e njëmbëdhjetë: Sa shpesh keni dëgjuar për Nismën për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse në Shqipëri?

Rezultatet që marrim nga kjo pyetje lidhen me rezultatet e pyetjes dhjetë. Të dhënat negative në pyetjen dhjetë sjellin rrjedhimisht që në pyetjen e njëmbëdhjetë 265 persona (53%) e të anketuarve kanë zgjedhur alternativën e tretë “Kurrë”. Pra vihet re mungesë informacioni rreth EITI-it. (Tabela 21)

How often do you hear about EITI Albania?

		Frequency	Percent
Valid	Always	33	6.6
	Not often	189	37.8
	Never	265	53.0
	Total	487	97.4
Missing	9.00	13	2.6
Total		500	100.0

Tabela 21

Pyetja e dymbëdhjetë: A keni qënë ndonjëherë pjesë e aktiviteteve të EITI-it Shqiptar /Shoqërisë civile?

Personat e anketuar në administratën lokale i janë pergjigjur Po kësaj pyetje. Pra kjo tregon qe administrata lokale është e informuar më së miri rreth Nismes EITI dhe kjo kryesisht nëpërmjet seminareve të shpeshta që Sekretariati ka kryer me administratën lokale. Pjesa tjetër e të anketuarve 471 persona (94.2 %), nuk kanë qënë asnjherë pjesë e ndonjë aktiviteti të EITI-it Shqiptar. (Tabela 22)

Have you ever participated in any EITI Albania / Civil Society activities?

		Frequency	Percent
Valid	Yes	16	3.2
	No	471	94.2
	Total	487	97.4
Missing	9.00	13	2.6
Total		500	100.0

Tabela 22

Pyetja e trembëdhjetë: A keni parë ndonjëherë ndonjë raport të EITI-it Shqiptar?

464 persona (92.8 %) e të anketuarve, rezultojnë që i janë përgjigjur negativisht kësaj pyetje.
(Tabela 23)

Have you ever seen a EITI Albania report?

	Frequency	Percent
Yes	26	5.2
Valid No	464	92.8
Total	490	98.0
Missing 9.00	10	2.0
Total	500	100.0

Tabela 23

Pyetja e katërbëdhjetë: A keni parë apo lexuar ndonjëherë broshura apo fletëpalosje informuese të EITI-it Shqiptar?

438 persona (87.6 %) e të anketuarve, rezultojnë që i janë përgjigjur negativisht kësaj pyetje.
(Tabela 24)

Have you ever seen or read any information brochure or flyer of EITI Albania?

	Frequency	Percent
Yes	51	10.2
Valid No	438	87.6
Total	489	97.8
Missing 9.00	11	2.2
Total	500	100.0

Tabela 24

Pyetja e pesëmbëdhjetë: Kur keni marrë pjesë herën e fundit në një takim me EITI-n Shqiptar/Shoqerinë Civile?

Shumica e të anketuarve përjashtuar personat e anketuar nga administrata publike, nuk kanë marrë asnjëherë pjesë në ndonjë takim me EITI-n Shqiptar. Kjo vihet nga përqindja e lartë e personave që nuk mbajnë mend të kenë marrë pjesë në takim me EITI-in Shqiptar/ Shoqerinë Civile 378 persona (75.6%). (Tabela 25)

When last did you attend any of EITI Albania/ Civil Society meetings?

	Frequency	Percent
A month ago	2	.4
A year ago	12	2.4
Valid Couple of weeks ago	8	1.6
I can't remember	378	75.6
Total	400	80.0
Missing 9.00	100	20.0
Total	500	100.0

Tabela 25

Pyetja e gjashtëmbëdhjetë: Përmes kujt merrni më shumë informacion nga EITI Shqiptar?

Alternativa më e klikuar nga punonjësit e administratës publike vihet re që është Seminare Sensibilizimi, ndërkohë që një pjesë e të anketuarve kanë zgjedhur alternativën e TV dhe Internetit. (Tabela 26)

Theksojmë se rezultatet e përgjigjeve në këtë pyetje tregojnë se pyetja nuk është kuptuar qarte, referuar përgjigjeve të pyetjes se gjashtë nga ku rezultonte se 363 persona, 72% e të anketuarve nuk kanë informacion për EITI-in Shqiptar.

Through which medium do you get information on the EITI Albania?

		Frequency	Percent
Valid	Radio	3	.6
	TV	167	33.4
	Newspaper	22	4.4
	Sensitization Seminar	25	5.0
	Internet	86	17.2
	Total	303	60.6
Missing	9.00	197	39.4
Total		500	100.0

Tabela 26

Pyetja e shtatëmbëdhjetë: Çfarë mjeti mendoni se duhet përdorur për publikimin e procesit EITI në Shqipëri?

Televizioni përbën burimin më të gjerë të informacionit në Shqipëri. Kjo vihet re edhe nga përgjigjet që kanë dhënë të anketuarit, ku 388 persona (77.6%) e të anketuarve, mendojnë që TV është mjeti më i mirë që duhet përdorur për publikimin e procesit EITI në Shqipëri e ndjekur nga alternativa e Internetit e zgjedhur nga 240 persona (48%).(Tabelat 27 - 31)

Radio

		Frequency	Percent
Valid	No	403	80.6
	Yes	70	14.0
	Total	473	94.6
Missing	9.00	27	5.4
Total		500	100.0

Tabela 27

TV

		Frequency	Percent
	No	85	17.0
Valid	Yes	388	77.6
	Total	473	94.6
Missing	9.00	27	5.4
Total		500	100.0

Tabela 28

Newspaper

		Frequency	Percent
	No	275	55.0
Valid	Yes	198	39.6
	Total	473	94.6
Missing	9.00	27	5.4
Total		500	100.0

Tabela 29

Sensitization Seminar

		Frequency	Percent
	No	290	58.0
Valid	Yes	182	36.4
	Total	472	94.4
Missing	9.00	28	5.6
Total		500	100.0

Tabela 30

Internet

		Frequency	Percent
	No	233	46.6
Valid	Yes	240	48.0
	Total	473	94.6
Missing	9.00	27	5.4
Total		500	100.0

Tabela 31

Pyetja e tetëmbëdhjetë: Keni ndonjë sygjërim për grupin e implementimit të EITI në Shqipëri?



Pyetja tetëmbëdhjetë, e fundit e pyetesorit, përbën një pyetje të hapur ku i është lënë hapësirë të anketuarve të japin sygjërimet për Sekretariatit EITI Shqiptar për të qënë sa më afër qytetarit për transparencën në industrinë nxjerrëse. Shumica e të anketuarve nuk i janë përgjigjur kësaj pyetjeje. Më poshtë citohen disa nga të anketuarit në lidhje me këtë pyetje.


“Duhet të organizojë seminare sensibilizimi, fletëpalosje, aktivitete dhe kronika televizive”

“Më shumë fushata apo seminare sensibilizimi dhe më shumë informacion për komunitetin për veprimtarinë dhe arritjet EITI”


“E domosdoshme të bëhet me shumë për transparencën”.

Shtojca Grafike






Pyetja 1




Pyetja 2

Do you know the name of the company/institution that is operating in this area?







Pyetja 3


Are you aware of any payments made by this/these company (ies)?




Pyetja 4











Pyetja 6








Pyetja 7









Pyetja 9




Pyetja 10




Pyetja 11




Pyetja 12




Pyetja 13




Pyetja 14



Pyetja 15



Pyetja 16



Pyetja 17

